



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 19.11.2024

Nr: 28

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 20, DATË 06.11.2024
TË DEPOZITUAR NGA Z. EVDAR KODHELI**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.11.2024, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Z. Evdar Kodheli

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 186, datë 09.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 19.11.2024 Nr: 28
Ora: 11:00



“Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 20 datë 06.11.2024 të depozituar nga z. Evdar Kodheli”

VËREN:

1. Z. Evdar Kodheli depozitoi pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, u regjistrua në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 20 regj., datë 06.11.2024. Në këtë kërkesë ankimore ankuesi kundërshton vendimin nr. 186, datë 09.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. KAS-i caktoi me short anëtarin z. Koli Bele si relator dhe vendosi zhvillimin e seancës paraprahe në datën 19.11.2024, ora 11:00. Në seancë ishin të pranishëm anëtarët e KAS-it dhe administrata e KQZ-së.
3. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 20, datë 06.11.2024;
 - Kërkesën nr. 03, datë 15.11.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Vendimin nr. 186, datë 09.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

KAS-i konstaton:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin nr. 186, datë 09.10.2024, si hap procedural përmbyllës për hetimin administrativ. Mbi këtë bazë KSHZ ka proceduar me kërkesën e tij nr. 03, datë 15.11.2024 për vendosje sanksioni administrativ për disa subjekte, ku bën pjesë edhe z. Evdar Kodheli.
2. Vendimi nr. 186, datë 09.10.2024 shpreh vetëm vullnetin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të vënë në lëvizje KAS-in me kërkesën për marrjen e masës administrative me gjobë. Ky vendim nuk sjell asnjë pasojë juridike dhe nuk cënon asnjë interes të palëve të prekura, sepse kompetenca për vendosje sanksioni administrativ është kompetencë e KAS-it.
3. Të drejtat e palëve të prekura, në rastet e procedimit me kërkesë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbrohen vetëm duke marrë pjesë si palë në shqyrtimin administrativ që zhvillohet nga KAS-i, dhe jo me procedurë ankimore ndaj vendimit përmbyllës të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i ,

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 20, datë 06.11.2024, të depozituar nga z. Evdar Kodheli.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 03.12.2024.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar